



E ardhmja nis me ne!



# “HORIZON SCHOOL”

Njësia në Lipjan



## RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

SHTATOR, 2023

## RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

### 1. Kushtet e përgjithshme

1.1. Në shkollën fillore dhe të mesme në "Horizon School" mund të regjistrohen të gjithë fëmijët e moshës 4-6 vjeç në ciklin parafillor, 6–10 vjeçarë në ciklin fillor, 11–15 vjeçare në ciklin e mesëm të ulët dhe fëmijët 15-19 vjeç në ciklin e mesëm të lartë, pa asnjë diskriminim në bazë kombëtare, etnike, fetare, gjinore, racore, sociale, gjuhësore, rajonale, etj., me kusht që t'i plotësojnë kërkesat e veçanta për regjistrim, siç janë:

- Aftësitë minimale psiko-fizike për vijimin e shkollimit të rregullt.
- Moshë adekuate për regjistrim në vitin e parë, respektivisht kryerja me sukses e klasës paraprake sipas planit dhe programit mësimor të Kosovës ose një plani dhe programi mësimor të pranuar nga MASHTI me aktin e licensimit, barasvlerës, apo me ndonjë akt tjetër juridik të aplikueshëm në Kosovë.
- Nënshkrimi i kontratës së shkollimit nga ana e prindit ose e kujdestarit të nxënësit dhe kryerja me rregull e obligimeve që dalin nga kjo kontratë.

1.2. Deri më 31 qershor të çdo viti kalendarik, shkolla shpallë vendet e lira për regjistrimin e nxënësve të rinj në vitin shkollor vijues. Shpallja bëhet në mjetet e informimit publik ose në mënyra të tjera të përshtatshme.

1.3. Regjistrimi i nxënësve të rinj për vitin shkollor vijues fillon më 1 korrik dhe vazhdon deri në fillim të vitit shkollor respektivisht deri në plotësimin e vendeve të lira.

1.4. Regjistrimi i nxënësve të rinj bëhet me përparësi sipas radhës së paraqitjes.

1.5. Regjistrimit të nxënësve në vitin e parë i paraprinë biseda me psikologun me qëllim të përcaktimit të shkallës së zhvillimit psiko-fizik të nxënësit.

1.6. Regjistrimi i nxënësve aktual të "Horizon School" në vitin shkollor vijues bëhet deri më dt. 10 gusht. Pas kësaj date vendet e nxënësve të paregjistruar shpallen të lira.

1.7. Kontratat për shkollim për të gjithë nxënësit e regjistruar në vitin shkollor vijues duhet të nënshkruhen më së voni deri më 15 gusht. Mosrespektimi i këtij afati do të konsiderohet si heqje dorë nga regjistrimi.

**Klasët:**

Nxënësit mund të regjistrohën në këto klasë:

- Parafillor
- Shkolla Fillore (I – V)
- Shkolla e Mesme e Ulët (VI-IX)
- Shkolla e Mesme e Lartë (X – XII)

Në vijim i gjeni të listuara të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrim të nxënësve sipas niveleve përkatëse:

**Niveli parafillor (mosha 4-6 vjeç)**

- Formulari për regjistrim (merret në webfaqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Një fotografi
- Raporti mjekësor / Certifikata shëndetësore
- 

**Niveli fillor (klasat I-V)**

- Formulari për regjistrim (merret në webfaqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Një fotografi
- Fletëkalimi (vlen për nxënësit nga klasa e II-të)
- Raporti mjekësor / Certifikata shëndetësore

**Niveli i mesëm i ulët (klasat VI-IX)**

- Formulari për regjistrim (merret në webfaqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Një fotografi
- Dëftesa për përfundimin e shkollimit fillor (fletëkalimi për nxënësit nga klasa e VII-të).
- Raporti mjekësor / Certifikata shëndetësore

## Niveli i mesëm i lartë (klasat X-XII)

Horizon School në nivelin e mesëm të lartë ofron drejtimin:

- Shkenca Natyrore

Dokumentet për regjistrim për ciklin e mesëm të lartë

- Formulari për regjistrim (merret në webfaqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Një fotografi
- Dëftesa për përfundimin e Shkollimit të mesëm të ulët (dëftesa e vitit paraprak për klasët XI dhe XII)
- Raporti mjekësor / Certifikata shëndetësore

### Shënim:

Nëse nxënësi regjistrohet në mes të gjysëmvetorit atëherë përveç dokumenteve të shënuara më lartë, duhet të sjellë edhe fletëkalimin nga shkolla paraprake.

Nëse nxënësi klasën paraprake e ka përfunduar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të nostrifikojë dëftesën pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas legjislacionit në fuqi.

### Afatet:

Regjistrimet në "Horizon School", fillojnë nga muaji Maj deri në muajin Shtator.

### Vërejtje:

Të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të plotësohen para se të nënshkruhet kontrata për shkollim, ndërkohë që fletëparaqitjet mund të pranohen edhe pa dokumente të kompletuara.